



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**  
**TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË**  
**TË VITIT 2022**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**PËR**

**ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E**  
**MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË**  
**TË VITIT 2022**

**Titulli:** Zbatimi i rekomandimeve të dërguara në Agjencinë e Prokurimit Publik, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Inspektoratin Qendror.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 177/1, datë 20.02.2023.

**Maj, 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>3</b>
<b>II.</b>	<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
	<b>1.</b> Objekti i auditimit	4
	<b>2.</b> Qëllimi i auditimit	4
	<b>3.</b> Metodologjia e auditimit	4
	<b>4.</b> Konkluzione	5
	<b>5.</b> Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
<b>III.</b>	<b>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm</b>	
	<b>1.</b> Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit	5
	<b>2.</b> Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	<b>3.</b> Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit	5
	<b>4.</b> Realizimi i rekomandimeve	5-30
<b>IV.</b>	<b>Konkluzione dhe Rekomandime për APP, AKSHI / AKU, IQ, AKSHI</b>	<b>19-20/ 29-30</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Agjencinë e Prokurimit Publik, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Inspektoratin Qendror, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 “Për organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për Shpërblim dëmi ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

### ***Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve:***

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së.

## II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 177/1 prot., datë 20.02.2023 me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e mëparshme realizuar në subjektet AKU, IQ, APP dhe AKSHI.

*Auditimi është kryer nga:*

1. E. C., *përgjegjëse grupi*
2. K. S., *anëtare*
3. R. A., *anëtar*
4. A. K., *anëtare*

### ***Çështjet e Audituara:***

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (*pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014*).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

### ***II.1 Objekti i auditimit***

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

### ***II.2 Qëllimi i auditimit***

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### ***II.3 Metodologjia e auditimit***

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “*Udhëzime mbi rregullat e auditimit*”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “*Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve*”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësive në të ardhmen.

## II.4 Konkluzione

Nga 2 auditimet në 4 subjekte, janë rekomanduar gjithsej **51 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar gjithsej 48 masa ose në masën 94% dhe 3 masa nuk janë pranuar ose në masën 6%. Verifikuam se, nga 48 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 27 masa ose në masën 56.3%, janë zbatuar pjesërisht 4 masa ose 8.3 % e totalit të masave të pranuar, janë në proces zbatimi 12 masa ose në masën 25% dhe pa zbatuar rezultuan 5 masa ose 10.4%.

### Përmbledhëse e masave të pranuar në %

Nga 48 rekomandime të pranuar	Nr.	%
Zbatuar	27	56.3
Zbatuar pjesërisht	4	8.3
Në proces	12	25
Nuk janë zbatuar	5	10.4

- Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga 2 auditimet e kryera, në 4 subjekte, AKSHI, nuk ka kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara.

- Gjithashtu konstatohet se, nga 2 auditimet e kryera, në 4 subjekte, AKU, AKSHI dhe APP, nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## II.5 Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 56%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatim ose janë zbatuar pjesërisht duhet akoma më shumë punë për realizimin në nivelin 100% të rekomandimeve.

## III. Zbatimi i Rekomandimeve të Lëna në Auditimet e Mëparshme

Auditimi në terren ka filluar në datën 20.02.2023 dhe ka përfunduar në datën 10.03.2023.

### 1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Më hollësisht, gjeni verifikimin e zbatimit të rekomandimeve sipas subjekteve si më poshtë:

#### 1.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit – AKU, Inspektorati Qendror – IQ dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit – AKSHI

**Mbi auditimin e ushtruar në AKU, IQ dhe AKSHI, në bazë të Programit të Auditimit nr.177/1 Prot, datë 20.02.2023.**

Në zbatim të pikave 1- 4 të Programit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”.

**Objekti i auditimit:** Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr.978/14 prot, datë 13.03.2022, drejtuar AKU-s, me shkresën nr.978/12 prot, datë 30.03.2022 drejtuar AKSHI-t dhe me shkresën nr.978/13 prot, datë 30.03.2022, drejtuar IQ-s.

Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 33 masa organizative. Nga këto janë pranuar plotësisht 31, nga të cilat janë zbatuar 15, janë në proces zbatimi 9, janë zbatuar pjesërisht 2 dhe janë pa zbatuar 5 masa organizative.

### **Përmbledhëse e Masave drejtuar institucioneve AKU, IQ dhe AKSHI.**

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime Gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
<b>MASA ORGANIZATIVE</b>	<b>33</b>	<b>31</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>5</b>

### **DREJTIMET E AUDITIMIT:**

**1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

AKU ka dërguar plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr.3411/6, datë 13.04.2022, duke respektuar afatin prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e Inspektoratit Qendror është hartuar dhe dërguar Plani i Zbatimit të rekomandimeve dhe është përcjellë pranë KLSH-s me shkresën nr. 44/6 prot., datë 21.04.2022, “Përcjellje e Planit të Zbatimit të Rekomandimeve”.

IQ ka respektuar afatin prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në respektim të nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

AKSHI nuk ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me objekt “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

AKU nuk ka dërguar raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, duke mos respektuar afatin prej 6 muajsh në kundërshtim me pika 2 e nenit 30 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e Inspektoratit Qendror është raportuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 44/8 prot., datë 29.09.2022. IQ ka dërguar raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, duke respektuar afatin prej 6 muajsh në respektim të pikës 2 në nenin 30 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

AKSHI nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**3. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e**

**realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.**

Trajtimi për ndjekjen e secilit rekomandim është përshkruar më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi aktet rregullative të brendshme që disponon AKU u konstatua se, Rregullorja e Brendshme nuk është e përditësuar në funksion të strukturës organizative pasi në të nuk janë paraqitur detyrat funksionale për Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i AKU, të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën krahas ndryshimeve të detyrave operacionale që mund të kenë ndryshuar të pasqyrohen dhe detyrat e sektorit të ri të Planifikimit Strategjik dhe Raportimit.

**Nga auditimi rezulton se:** Rekomandimi rezulton i zbatuar, rregullorja e brendshme është përditësuar duke përfshirë edhe sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 127/2 prot., datë 23.06.2022 Urdhri nr. 297, datë 23.06.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

***Rekomandimi është zbatuar***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, AKU nuk ka ndërtuar dhe miratuar një strategji institucionale me elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit.

**2.1 Rekomandimi:** AKU të marrë në konsideratë elementë të strategjisë së teknologjisë së informacionit në hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale që do të zhvillojë në vitet në vijim, e cila në të gjithë hallkat e saj duhet që nëpërmjet teknologjisë të mbështesë arrijten e objektivave të institucionit. Për ofrimin e shërbimeve elektronike AKU të bashkëpunojë me AKSHI-n, si institucion përgjegjës për hartimin e strategjisë së agjendës digjitale dhe bashkërendimin e planit të veprimit për këto shërbime.

***Përgjigja e Institucionit AKU me shkresën nr.177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023:*** Brenda këtij viti parashikohet hartimi i zhvillimit të planit strategjik për AKU, për periudhën 2022-2027 ku do të parashikohen dhe elementët e strategjisë së teknologjisë së informacionit.

**Nga auditimi rezulton se:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit me të cilin AKU ka observuar Projektraportin e Auditimit lidhur me statusin e këtij rekomandimi vlerëojmë se meqë hapat për hartimin e strategjisë janë në proces realizimi atëherë ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

***Rekomandimi është në proces***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimet TIK që ofron AKSHI kundrejt Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe IQ, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/ përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

**3.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

**Nga auditimi rezulton se:** Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion nga ana e AKU një draft marrëveshje e cili është hartuar në datën 28.02.2023. Ndërsa AKSHI në informon se është nënshkruar marrëveshja ndërmjet tij dhe MBZHR, ku AKU është pjesë si institucion varësie. Megjithatë AKU nuk është në dijeni të kësaj marrëveshje, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

***Rekomandimi është zbatuar***

**3.2 Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

**Nga auditimi rezulton se:** Janë dërguar kërkesat për bashkëpunim me AKSHI-n për disa çështje të lëna nga auditimi, për këtë ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar nga IQ.

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht***

**4. Gjetje nga auditimi:** IQ nuk disponon raporte periodike të mirëmbajtjes së sistemit e-inspektimi edhe pse është administrator i portalit E-inspektimi sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik eInspektimi”.

**4.1 Rekomandimi:** AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes për sistemin e-inspektimi të marrë masat për vënien në dijeni të institucionit përfitues të shërbimeve të mirëmbajtjes që në këtë rast është IQ me qëllim informimin e institucionit mbi problematikat e raportuara nga IQ.

**Nga auditimi rezulton se:** Nga verifikimi i dokumentacionit mbi ndjekësit e kontratës së mirëmbajtjes të sistemit e-inspektimi nr.255 prot., datë 14.01.2021 me object “Mirëmbajtje e sistemit e-inspektimi për IQ” e cila ka përfunduar në 14 janar 2023, nga IQ si institucion përfitues nuk ka pasur asnjë përfaqësim, por ndjekja e kontratës, është bërë nga punonjësit e AKSHI-t. Ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar me qëllim që të merret në konsideratë në kontratën e re që pritet të realizohet, për mirëmbajtjen e sistemit e-inspektimi.

***Rekomandimi është i pazbatuar***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si dhe Inspektorati Qendror nuk disponojnë regjistër rishikues me elemente të teknologjisë së informacionit. Për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jenë identifikuar, dokumentuar, analizuar dhe vlerësuar risqe lidhur me teknologjinë e informacionit që disponojnë institucionet.

**5.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masa për hartimin e regjistrit të riskut për teknologjinë e informacionit në institucionet respektive, ku të jenë evidentuar ngjarje të mundshme të cilat mund të kenë efekt negativ në mbarëvajtjen e punës institucionale, me qëllim krijimin e një plani pune në rastet e shfaqjes së problematikave të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Risqet e identifikuar që lidhen me funksionalitetin e sistemit “e-inspektimi” t’i adresohen IQ dhe AKSHI-t si administrator të këtij sistemi.

**Nga auditimi rezulton se:** IQ, si administrator i të dhënave të inspektimit ka evidentuar dhe dokumentuar risqe që lidhen me teknologjinë e informacionit, në përputhje me rekomandimin. Për këtë ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

***Rekomandimi është zbatuar***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- IQ nuk ka hartuar dhe miratuar politika, procedura apo akte rregullative që garantojnë sigurinë e informacionit, procedura për back-up të të dhënave të sistemit e-inspektimi ku bën pjesë dhe AKU, rregullore për trajtimin e gabimeve që mund të ndodhin në infrastrukturën TIK, menaxhimin e incidenteve, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit online në rast ndërprerje.

- IQ nuk disponon rregullore për administrimin e përdoruesve të sistemit, ku të jenë përcaktuar hapat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve, të drejtave, fjalëkalimeve si dhe raportimin e tyre.



**6.1 Rekomandimi:** IQ të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe vënien në dispozicion të procedurave apo akteve rregullative për administrimin e përdoruesve si dhe informimin e tyre për elementët e sigurisë së informacionit që ka miratuar institucioni që lidhen me inspektimet online, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

IQ të adresojë tek AKSHI përgjegjësinë teknike për zbatimin në elementët e sigurisë së informacionit, back-upin e të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit të inspektimit në rast ndërprerje.

**Nga auditimi rezulton se:** Nga verifikimi i dokumentacionit në IQ, vlerësojmë se rekomandimi është zbatuar nga ana e Inspektoratit.

*Rekomandimi është zbatuar*

**7.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e inspektorëve dhe verifikimi i tyre nga sistemi u konstatua se:

- Datëlindja, është e njëjtë për të gjithë 1/1/1970;
- Adresa NID, është e pasaktë dhe e njëjta ID për të gjithë user-at 1234567890;
- Gjuhë e huaj, është fushë boshe;
- I vlefshëm deri më, vendosur data 12/31/2999;
- Rajoni, jo në çdo user është plotësuar;
- Modified, në disa user-a nuk del edhe viti se kur është bërë modifikimi i fundit por vetëm data dhe muaji.

**7.2 Gjetje nga auditimi:** - Datë të mirëfilltë largimi të punonjësit nuk ka në sistem, si e tillë merret i mirëqenë modifikimi i fundit kur është bërë inactive;

- Nuk ka asnjë lloj informacioni për përdoruesit e fshirë;
- Mbajnë statusin “aktiv” përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me AKU. Rastet e konstatuara janë inspektorë të cilët janë larguar për arsye të ndryshme si: mbushja e moshës për pension pleqërie, dorëheqja si dhe përdorues të tjerë;
- Ka raste kur i njëjti punonjës ka më shumë se një përdorues;
- Në disa raste ka mospërputhje të pozicionit të punës dhe rolit të tij në sistem, p.sh.; punonjësi emëruar në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme ka akses në sistem dhe roli që ky specialist ka në sistem është si Kryeinspektor Rajonal;
- Një përdorues është me emrin “Ligjor AKU” në DRAKU Tiranë me rol në sistem “Ligjor Inspektorati” dhe Inspektor AKU si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren;
- Nga njoftimi i fillimit të punës në hapjen apo mbylljen e user-it ka një afat më të gjatë në hapjen e tij në kundërshtim me VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi””.

Nga auditimi u konstatua se, në disa raste të përzgjedhur rastësisht dhe verifikimi i tyre ka rezultuar se nga këto shembuj ka afate gati dhe për një periudhë 1 vit nga largimi i punonjësit deri në mbylljen e aksesit për të, apo edhe afati i gjatë nga momenti që është punësuar deri në hapjen e një përdoruesi në sistem;

- Ka user-a të cilët janë hapur përpara se të hynte AKU në sistemin e e-Inspektimit si p.sh., user-a të cilët janë krijuar në sistem në vitin 2015, 2016 dhe 2017 ndërkohë AKU është futur në sistem në vitin 2018, gjithashtu përdoruesit si inspektorë pavarësisht se është e punësuar në PIK të cilët nuk kanë ende akses në sistem.

**7.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ si përgjegjës për të dhënat e sistemit e-inspektimi të verifikojnë dhe të sistemojnë të dhënat mbi përdoruesit. IQ të adresojë tek AKSHI si administrator i sistemit dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të gjitha rastet që do të

konsiderohen si anomali të sistemit me qëllim saktësimin dhe plotësimin e tyre nga ofruesi i shërbimit.

**Nga auditimi rezulton se:** Shkresat që AKU I ka vendosur në dispozicion grupit të auditimit janë kërkesa për hapje user-i nga AKU dhe kthim përgjigje nga IQ, një process që është kryer dhe më parë, ndërkohë rekomandimi i KLSH-së është për verifikimin dhe sistemimin e të dhënave mbi përdoruesit e sistemit e-inspektimi. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar nga AKU. Nga IQ është mbajtur dokumentacioni lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi mbi realizimin trajnimit për burimet njerëzore. Veprimet sistemuese të të dhënave mbetet të kryehen nga cdo inspektorat.

***Rekomandimi është në proces zbatimi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dhomës së serverëve në AKU, u konstatua se ambientet fizike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në “*Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave*” (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

Disa nga problematikat e konstatuara, janë të renditura si më poshtë:

- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këto hapësira, ku kanë akses specialistët e TI, nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem të kufizimit të personave të paautorizuar;
- Aksesit në ambientin e dhomës së serverave nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.;
- Instalimi elektrik i dhomave të serverave nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm;
- Mungon sistemi i alarmit. Duhet të ketë të tillë në mënyrë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

**8.1 Rekomandimi:** AKSHI si institucioni administrues për teknologjinë e informacionit në AKU të marrë masa për identifikimin e të dhënave që ruhen jashtë sistemit elektronik, por që janë të rëndësishme për punonjësit dhe vetë AKU-n, pasi lidhen drejtpërdrejtë me detyrat e tyre funksionale apo raportuese, në mënyrë që të gjejë zgjidhjen ekonomikisht më të favorshme në ruajtjen e tyre.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse sistemi po testohet në ofrimin e shërbimeve ku disa prej tyre ishin jashtë sistemit e-inspektimi, ky rekomandim vlerësohet në process zbatimi.

***Rekomandimi është në proces zbatimi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web të Inspektoratit Qendror, nëpërmjet së cilës aksesohet dhe portali “e-inspektimi” u konstatua se, nuk përdoret një lidhje e sigurt (connection security) HTTP (Hyper Text Transfer Protocol) dhe HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure) (Not Secure Status). Mungesa e kësaj certifikate mbart riskun e cenimit të privatësisë, ndryshimit të informacionit dhe shkëmbimit të tij përmes këtij portali.

**9.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për sigurimin e faqes web të IQ, nëpërmjet të cilit të gjithë inspektoratet aksesojnë sistemin elektronik të inspektimit “e-inspektimi”.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim është zbatuar.

***Rekomandimi është zbatuar***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sipas përcaktimeve të VKM nr. 696, datë 16.08.2013 dhe VKM nr. 673 datë 22.11.2017, Inspektorati Qendror dhe AKSHI janë të dy institucione administrues të aplikacionit informatik “e-inspektimi”. Sipas pikës 2 paragrafi X i VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të

kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pikës gj, paragrafi II në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”, në të cilat respektivisht citohet se:

- Inspektorati Qendror është përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Portalit, i cili mbahet në format elektronik. Regjistrimi, përpunimi, përdorimi, publikimi dhe ruajtja e të dhënave e informacionit në të kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.

- AKSHI ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Konstatimi i referohet pikës 2, paragrafi X i VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” dhe pika gj. paragrafi II në VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar”.

**10.1 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si administratore të sistemit “e-inspektimi” mbështetur në aktet ligjore respektive, të ndjekin hapat e nevojshëm ligjorë për interpretim dhe shfuqizim nëse do të jetë e nevojshme të një prej neneve që mbivendosin të drejtën administrative të këtij sistemi.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse kërkesa nga Inspektorati është përcjellë tek institucionet vendimarrëse, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar për aq sa i takon institucionit.

**Rekomandimi është zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat shtetërore të AKU dhe IQ u konstatua se, AKSHI edhe pse institucion administrues i sistemeve dhe aplikacioneve, njëkohësisht dhe Autoriteti Rregullator Koordinues, ka kërkuar nga IQ dhe AKU përmbushjen e një detyrimi ligjor lidhur me regjistrimin e të dhënave që gjenerojnë si të dhëna shtetërore.

Në nenin 7, pika 1 të VKM nr.945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””, citohet se “Institucioni, i cili kërkon të krijojë një bazë të dhënash shtetërore, bashkëpunon me ARK-në për përgatitjen e dokumentacionit të bazës së të dhënave”, tregon se nevojitet një bashkëpunim nga ana e AKSHI-t, jo thjesht delegim tek institucionet plotësimi i detyrimeve ligjore për bazat e të dhënave shtetërore.

IQ dhe AKSHI nuk kanë në strukturën e tyre asnjë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit, për administrimin e të dhënave të cilat janë aktualisht pa përgjegjësi. Administrimi i të dhënave është përgjegjësi e institucionit që i krijon ato.

**11.2 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sistemi e-inspektimi është në funksion dhe ndërvepron me sistemin e QKB, në kundërshtim me:

- Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore”, ku citohet se “1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore”;

- Nenin 9 pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” ku citohet se “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore”.

**11.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masat e nevojshme për ndryshime në strukturën e tyre institucionale me qëllim shtimin e një ose më shumë pozicioneve që do të kryejnë detyrat e administrimit të të dhënave që secili prej institucioneve krijon dhe administron në mënyrë elektronike. Administrimi i të dhënave është një shërbim që nuk i ngarkohet dhe nuk e mbulon AKSHI me specialistët e tij në institucionet tuaja.

Përgjigja e Institucionit AKU me shkresën nr.177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023: Sistemi i ri implementuar në AKU, nuk do të përbëjë krijim të një databaze të re shtetërore, por do të jetë një sistem i brendshëm i organizimit të punës së AKU. Për këtë arsye, rekomandimi për shtimin e një pozicioni në strukturë për administrimin e të dhënave nuk gjen zbatim për aq kohë sa AKU nuk do të prodhojë dhe administrojë të dhëna nëpërmjet AKUNet por do të përdorë të dhëna nga ndërveprimi I sistemeve dhe databazave egzistuese shtetërore.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet i papranuar nga AKU. IQ, me regjistrimin e të dhënave si të dhëna shtetërore, nevojitet të përfshijë në strukturë administrator të të dhënave shtetërore.

***Rekomandimi është i papranuar***

**11.2 Rekomandimi:** AKSHI si Autoriteti Rregullator Koordinues, me ndryshimin e strukturës dhe përcaktimin e punonjësve përgjegjës, për të dhënat elektronike që disponojnë apo krijojnë institucionet IQ dhe AKU, të bashkëpunojë për regjistrimin e bazës së të dhënave duke pasur në konsideratë identifikimin e të dhënave parësore, të dhënat dytësore dhe çdo element që është i nevojshëm me qëllim përfundimin e procesit të regjistrimit të të dhënave shtetërore të inspektimit.

**Nga auditimi rezulton se:** Kjo shkresë u verifikua në IQ, për këtë arsye ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

***Rekomandimi është zbatuar***

**11.3 Rekomandimi:** AKSHI të marrë masa të menjëhershme në identifikimin e përgjegjësive për ndërveprimin e ndërtuar dhe lejuar ndërmjet një baze të dhënash shtetërore sic është ajo e QKB me një bazë të dhënash jo shtetërore sic është ajo e inspektimit.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi për sa kohë jeni në pritje të miratimit të databazës shtetërore.

***Rekomandimi është në proces zbatimi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore ku bën pjesë dhe AKU, aktualisht janë në fazë ristrukturimi, kërkesa dërguar Kryeministrit me shkresën nr.561, datë 20.12.2021 nga Inspektorati Qendror. Me miratimin e këtij ristrukturimi, inspektoratet shtetërore do të jenë pjesë e Inspektoratit Qendror, përfshirë dhe AKU. Për këtë arsye për përmirësimin e sistemit AKU-net duhet të merren në konsideratë ndryshimet ligjore të propozuara të cilat ndikojnë në veprimtarinë e AKU.

**12.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe AKU të marrin në konsideratë ndryshimet ligjore të cilat do të ndikojnë tek AKU me miratimin e ri-organizimit të trupave inspektuese kërkuar nga Inspektorati Qendror, në mënyrë që përmirësimi i sistemit të jetë në përputhje me këto ndryshime duke siguruar në këtë mënyrë mirë administrimin e fondeve për këtë qëllim.

**Nga auditimi rezulton se:** Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se kontrata për sistemin informatik AKUNet të AKU është nënshkruar në gusht 2022, pra afërsisht 4 muaj pas dërgimit të këtij rekomandimi. Meqënëse ky rekomandim i referohet një ndryshimi struktural të trupave inspektuese i cili akoma nuk ka përfunduar dhe sistemi informatik për AKUNet është prokuruar, ky rekomandim konsiderohet i pazbatueshëm.

***Rekomandimi është i papranuar***

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi workflow dhe manualët e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi”, u konstatua se materialet udhëzuese workflow, manuale dhe video prezantimi, janë hartuar sipas hapave inspektues bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet njoftimi paraprak i subjekteve, ndërkohë që AKU nuk kryen inspektime me njoftim paraprak të

subjekteve në inspektim. AKU nuk mund të jetë pjesë e unifikimit të hapave inspektues lidhur me njoftimin paraprak, për këtë arsye dhe në manualet e inspektimeve duhej të trajtohet ndryshe nga inspektimet e tjera, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 32 “Njoftimi i inspektimit”, pika 2.a dhe 2.b.

**13.1 Rekomandimi:** IQ si institucioni përgjegjës për unifikimin e hapave të inspektimit në bashkëpunim me AKU të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e workflow, ndërsa AKSHI për hartimin e manualeve në përputhje me aktivitetin e AKU, sipas përcaktimeve që bën ligji për kryerjen e inspektimeve pa njoftim paraprak, ashtu sikurse ndodh në sistemin e-inspektimi.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse të tre institucionet kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin e manualeve lidhur me inspektimin, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi është zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit elektronik e-inspektimi u konstatua se, AKU ka vijuar aktivitetin jashtë sistemit informatik e-inspektimi për modulet Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative, në kundërshtim me rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”, në të cilin janë përcaktuar detyrimet për hedhjen e të dhënave në modulet Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore dhe Vendimet Administrative, referuar nenit 11 në rregulloren e miratuar me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2016 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimeve e-inspektimi”.

**14.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror të marrë masa për trajnimin e punonjësve të AKU për modulet që rezultojnë të pa informatizuar: Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative; në mënyrë që informatizimi për të dhënat në këto module të sistemit e-inspektimi, të fillojë sa më parë.

Përgjigja e Institucionit AKU me shkresën nr.177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023: Në lidhje me realizimin e këtij rekomandimi është zhvilluar trajnimi në kuadër të marrjes së masave për organizimin e trajnimeve pranë ambienteve të IQ.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse në listëprezencën e punonjësve të trajnuar për AKU kanë qenë punonjës të strukturës së burimeve njerezore, ky rekomandim konsiderohet I zbatuar.

**Rekomandimi është zbatuar**

**14.2 Rekomandimi:** AKU të marrë masa që me përfundimin e trajnimit të punonjësve që kryejnë detyra në: Protokoll Arkiva, Burimet Njerëzore, Vendimet Administrative; të fillojnë hedhjen e të dhënave në sistemin e-inspektimi.

Përgjigja e Institucionit AKU me shkresën nr.177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023: Në lidhje me realizimin e këtij rekomandimi është zhvilluar trajnimi në kuadër të marrjes së masave për organizimin e trajnimeve pranë ambienteve të IQ.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse në listëprezencën e punonjësve të trajnuar për AKU kanë qenë punonjës të strukturës së burimeve njerezore, ky rekomandim konsiderohet I zbatuar.

**Rekomandimi është i zbatuar**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi outputin e sistemit e-inspektimi u konstatua se, buletinet statistikore të inspektimeve të AKU popullohen manualisht dhe ruhen jashtë sistemit informatikë e-inspektimi. Të dhënat që buletinet përmbajnë, gjenden të regjistruara në sistemin e-inspektimi, por gjenerimi i raportimeve nga sistemi e-inspektimi nuk është bërë në përputhje me kërkesat funksionale të AKU. Kjo formë jo vetëm është një punë e dyfishtë për

inspektorët që duhet të bëjnë raportimet jashtë sistemit, por rrit mundësinë për raportime jo të sakta. Mënyra e gjenerimit të të dhënave në trajtë raportesh nga sistemi e-inspektimi nuk mundëson modelet e raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

Nga auditimi u konstatua se AKU deri në këto momente, nuk ka arritur të përfitojë nga funksionaliteti i sistemit “e-inspektimi” përcaktuar në nenin 8/vi në rregulloren e miratuar nga Inspektorati Qendror me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitetet është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

Konstatimi i referohet nenit 8/vi në rregulloren e miratuar nga Inspektorati Qendror me urdhrin nr.432, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të “e-inspektimit”” ku citohet se një nga funksionalitete është “Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e inspektimit”.

**15.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n, si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për automatizimin e buletineve statistikore në sistemin informatik të inspektimit me qëllim minimizimin e raportimeve manuale që kryejnë gjithë përdoruesit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit përfshirë dhe inspektorët.

**Nga auditimi rezulton se:** Janë kërkuar nga IQ tek AKU të dhëna mbi informatizimin e buletineve statistikore, por AKU nuk është përgjigjur. Ndërsa, AKSHI-t nuk i është përcjellë ende një kërkesë për këtë çështje pasi nuk janë mbledhur të dhënat nga AKU, automatizimi buletineve statistikore në sistemin informatik të inspektimit, rezulton ende i painformatizuar.

***Rekomandimi është i pazbatuar***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi historikun dhe aksesin në të dhëna u konstatua se, në sistemin e-inspektimi, AKU përballet me një papërshtatshmëri funksionale dhe operacionale. Nisur sa më sipër, nga auditimi u konstatua se:

- Mungojnë të dhënat me rekordet historike të AKU për periudhën 2012-2018 të cilat nuk janë importuar në sistemin e e-inspektimi si rekorde historike të inspektimeve përgjatë periudhës 2018 – 2021; Drejtoria qendrore e AKU disa herë i është drejtuar IQ për problematikat që ndeshin në sistemin e-inspektimi të cilat pengojnë aktivitetin e institucionit. Me anë të shkresës nr.1197, datë 05.03.2020 drejtoria qendrore i është drejtuar IQ përveç të tjerave dhe për importimin e të dhënave historike të AKU-net në sistemin e-inspektimi;

- Të dhënat e inspektimeve të ruajtura në bazën e të dhënave të IQ-së për periudhën 2018 e në vazhdim nuk janë të disponueshme për gjithë punonjësit që zhvillojnë analiza apo monitorime të inspektimeve të AKU-së me qëllim vlerësimin e riskut apo vlerësimin e performancës së inspektorëve të vet; Kjo çështje është trajtuar në detaje tek “Siguria e të dhënave dhe përdoruesit e sistemit”;

- Inspektori nuk ka të drejtë të shohë rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin ku ai ndodhet nëse nuk ka qenë vetë ai për inspektim, duke e bërë të pamundur kontrollin për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm;

**16.1 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrë masat për përmbytje nga ana e OE detyrimit për importimin e të dhënave historike të AKU në sistemin e-inspektimi për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshme të të dhënave inspektuese që janë kryer ndër vite.

**Nga auditimi rezulton se:** Meqënëse ky rekomandim i drejtohet dy institucioneve AKSHI-t dhe IQ-s, dhe realizimi i tij kërkon bashkëpunimin ndërmjet tyre, Hapat e ndërmarrë për këtë bashkëpunim nuk janë të mjaftueshëm për të arritur në një përmbytje në realizimin e tij. Për këtë arsye ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

***Rekomandimi është i pazbatuar***

**16.2 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të kërkojnë përmbushjen nga OE, të drejtën për të parë në sistem rezultatin e inspektimit të mëparshëm të zhvilluar në subjektin nga çdo inspektor që është aktualisht për inspektim.

*Nga auditimi rezulton se:* Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

*Rekomandimi është zbatuar*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi gjurmën e auditimit (audit log) u konstatua se, për sistemin e-inspektimi mungon gjurma elektronike e auditimit (audit log) sipas përcaktimeve të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale miratuar me urdhrin nr.109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

**17.1 Rekomandimi:** IQ me ndryshimet në strukturën e saj, të fillojë sa më shpejt marrjen e masave për identifikimin e të dhënave që nevojiten të ruhen për garantimin e gjurmës elektronike sic parashikojnë udhëzimet dhe t'i delegojë këto kërkesa tek ndjekësit e kontratës që është AKSHI. Nëpërmjet sigurimit të kësaj gjurme investigimi mbi të dhënat e ndryshuara apo të fshira do të jetë më i lehtë për institucionin i cili do të mbajë përgjegjësinë e administrimit të këtyre të dhënave.

*Nga auditimi rezulton se:* Duke qenë se institucionet janë në pritje të miratimeve ligjore dhe aktualisht kontrata e mirëmbajtjes së sistemit e-inspektimi është në proces, është bërë e mundur ruajtja e logeve për aq sa lejon sistemi. Për këtë ky rekomandim konsiderohet në proces.

*Rekomandimi është në proces sbatimi*

**17.2 Rekomandimi:** AKSHI të marrë masat në lidhje me sigurimin nga ana teknike të ruajtjes së gjurmës elektronike e cila do të ketë për qëllim sigurimin e investigimit të detajuar të veprimeve që ndodhin në sistemin e-inspektimi nga përdoruesit e tij.

*Nga auditimi rezulton se:* Masat e ndërmarra për plotësinë dhe ruajtjen e logeve të çdo sistemi informatik i cili ka përgatitur aktet ligjore për t'u identifikuar si bazë të dhënash shtetërore, është detyrim. Përgjigja juaj nuk jep asnjë detaj lidhur me sa është kryer për këtë çështje. Për këtë arsye ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

*Rekomandimi është i pazbatuar*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave output që gjenerohen nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatua se:

- Nuk është e mundur marrja në kohë reale e të dhënave për indikatorë të veçantë në rang qarku apo në rang kombëtarë;
- Gjenerimi i të dhënave statistikore eksportohet në excel për analiza dhe formate të mëtejshme, pasi dalin rreshtat e përsëritur të të dhënave;
- Për inspektorët nuk mbahen të dhëna për: Periudhë prove, Ka dhënë provim, Rezultati i provimit, Data e dhënies së provimit, i certifikuar, Fillimi i certifikimit, Përfundimi i certifikimit, Performanca, Datë mbyllje apo ç 'aktivizim të përdoruesit;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh për inspektimin online në lidhje me Inspektimet që janë kryer apo në proces në çdo Operator Biznesi Ushqimor - OBU (historiku i inspektimeve), Inspektimet në të gjithë vendin, Inspektimet me data në të gjithë vendin;
- Nuk gjenerohen të dhëna në trajtë raportesh me fjalë kyçe si "Prodhim përpunim qumështi" apo "Drejtuesi Teknik", etj.;
- Nuk janë bërë të dhëna të detyrueshme "mandatory field", ku plotësimi i tyre të mos lejojë kalimin në një fazë tjetër.

**18.1 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të marrë masat për ndërtimin e raporteve në

sistemin e-inspektimi, me qëllim ofrimin e kushteve të raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar, derisa nuk është ndërmarrë asnjë komunikimin për plotësimin e tij.

***Rekomandimi është i pazbatuar***

**18.2 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, në bashkëpunim me IQ dhe AKU të identifikojë të dhënat e detyrueshme të listë kontrollit, për vendosjen e tyre duke i parametrizuar ato të detyrueshme dhe në sistem.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi, bazuar në faktin se janë identifikuar dhe kërkuar përmirësimet në listë kontrollet e inspektimit për llogari të AKU.

***Rekomandimi është në proces zbatimi***

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe monitorimi në terren mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi nga inspektorët e AKU u konstatuan disa mangësi të cilat renditen si më poshtë:

- Punonjësit logohen në sistem me pajisjet tabletë duke u lidhur me internetin e celularit personal. Në të dy rastet e monitorimit nga audituesit u shfrytëzuan pajisje personale për plotësimin e inspektimit online. Për ruajtjen e rekordeve përdoruesit që janë inspektorët shtypin “Save” herë pas here, ku për shkaqe të ndërprerjes së internetit apo difekteve në “Touch” të pajisjeve, ju duhet të përsëritin hedhjen e të dhënave sepse nuk janë ruajtur dhe duhet të riaksesojnë përsëri sistemin.

- Sistemi nuk të jep mundësinë e plotësimin të urdhrin apo vendimit mbi të cilin po bëhet plani i monitorimit, monitorime këto të cilat mund të zhvillohen në kohë të ndryshme, nga arsye të ndryshme dhe me kërkesa të pakufizuara;

- Opsioni “Nuk aplikohet” mungon në pothuajse të gjitha listë kontrollet si përpunimi i qumështit, tregtim peshku, thertore etj.;

**19.1 Rekomandimi:** AKU në bashkëpunim me IQ të marrin masat, për sigurimin e internetit dhe riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve tablet të inspektorëve të AKU në mënyrë që inspektorët të kryejnë në mënyrë të sigurtë dhe pa ndërprerje detyrat inspektuese në terren.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

***Rekomandimi është zbatuar***

**19.2 Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKSHI-n si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për evidentimin e të gjithë fushave në listat e kontrollit që nuk është vendosur opsioni “Nuk aplikohet”. Nëse kjo është kërkuar, por nuk është realizuar nga OE, atëherë të përlllogariten penalitete mbi vlerën e mirëmbajtjes, në përputhje me kohën që kur kjo kërkesë apo dakordësim është marrë nga OE.

**Nga auditimi rezulton se:** Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.

***Rekomandimi është zbatuar***

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdorimin e sistemit informatik e-inspektimi dhe hyrjen e të dhënave gjatë inspektimeve nëpërmjet sistemit e-inspektimi u konstatuan disa mangësi, konkretisht:

- AKU nuk informohet në mënyrë periodike në asnjë formë nga QKB për subjektet e hapura kohët e fundit të cilët kanë veprimtari me objekt inspektimi nga AKU. E njëjta situatë është edhe për subjektet që kanë mbyllur veprimtarinë, të cilët AKU i ka planifikuar për inspektim si rezultat i mungesës së informacionit.



- Me zgjedhjen e llojit të inspektimit nuk është bërë e mundur nëpërmjet sistemit inspektorët të zgjidhen nga lista e sektorit që do të kryejë atë lloj inspektimi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e tyre dhe sektorin në të cilin ndodhen, çfarë do të garantonte që për çdo inspektim janë zgjedhur inspektorët e lejuar për ta kryer.
- Në listat e kontrollit ka kërkesa të cilat kontrollohen dhe nga institucione të tjera inspektuese si p.sh: largimi i mbetjeve, ujërave të ndotura etj., të cilat vetë subjektet u shprehën se kontrollohen dhe nga inspektorati i mjedisit.
- Në sistemin e-inspektimi nuk rezulton të jetë implementuar procedura e asgjësimit së bashku me procesverbalin përkatës, por ky proces ndiqet jashtë sistemit edhe pse ai është i rëndësishëm po aq sa inspektimi.
- Në listat e kontrollit në sistem nuk është aplikuar në asnjë rast plotësim me zgjedhje nga një numër mundësish që mund të mirëmbahet lehtësisht në sistem, duke ndikuar sadopak në kohë që nevojitet për plotësimin e listë kontrollit në subjekt.
- Në listat e kontrollit ka përsëritje të fushave që do të thotë se do të ketë plotësime me informacion përsëritës, duke rritur në këtë mënyrë fiktivisht kohën e plotësimit si p.r.sh. drejtuesi teknik është një nga fushat të cilat plotësohet dy herë nga inspektori, por kjo nuk është e vetmja.
- Në krijimin e çështjeve gjatë përzgjedhjes së aktivitetit nuk janë të gjitha kategoritë e aktiviteteve, por nga AKU nuk janë kërkuar shtime të aktiviteteve të tjera të nevojshme.
- Lista e Qendrës së Depurimit të Midhjes nuk të lejon aksesimin e gjenerimit në sistem me firmën Digjitale, por punohet nëpërmjet versionit web të aplikacionit.

**20.1 Rekomandimi:** IQ me bashkëpunimin e AKU-s, pas përfundimit të regjistrimit të dhënave shtetërore, të hartojë dhe delegojë tek AKSHI kërkesën për ndërveprim me të dhënat e regjistrimit të biznesit në QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike, me qëllim lehtësimin e planifikimit inspektues. Ky ndërveprim do ti shërbejë jo vetëm AKU por gjithë inspektoriateve.

*Nga auditimi rezulton se:* është hartuar një draft marrëveshje ndërmjet QKB dhe AKU-s e cila nuk është konkretizuar me një miratim dypalësh. Të dhënat mbi subjektet që mbyllen apo pezullohen është një proces në vazhdimësi. Dokumentet tregojnë vetëm për një rast një listë subjektësh, të cilat nuk kanë ardhur si një rezultat i bashkpunimit me QKB. Meqënëse ka një nisje të këtij procesi, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

**20.2 Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKU-n të identifikojnë nevojat për përmirësim të sistemit e-inspektimi që kanë të bëjnë me procese të inspektimit, mbetur jashtë sistemit si procedura e asgjësimit prej fillimit deri në procesverbalin përkatës.

*Përgjigja e Institucionit AKU me shkresën nr.177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023:* Asgjësimi kryhet sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht nenit 69 i ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “për ushqimin” i ndryshuar, përcakton se asgjësimi bëhet me procesverbal të rregullt dhe sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacion.

*Nga auditimi rezulton se:* Meqnëse IQ në takimin e organizuar me AKU, ka dakortësuar hartimin e Listave të Verifikimit për procedurën e asgjësimit të mallrave të papërshtatshme për konsum, por AKU nuk ka vijuar për realizimin e tyre, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**20.3 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror të identifikojë të dhënat inspektuese që përsëriten nga inspektorate të tjerë dhe që janë njëkohësisht në listë kontrollet e AKU, me qëllim eliminimin e kontrollove të dyfishta në subjektet që inspektohen.

*Nga auditimi rezulton se:* Meqënëse ka nisur një proces për bashkrendimin e inspektimeve të cilat nga verifikimi do të tregojnë se cilat janë të dhënat përsëritëse, ky rekomandim konsiderohet I zbatuar.

*Rekomandimi është zbatuar*

**20.4 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, por dhe administrues i sistemit të QKB, me përfundimin e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, të marrë masa për realizimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit e-inspektimi dhe sistemit të QKB, për shkëmbimin e informacionit mbi subjektet e hapura dhe të mbyllura në mënyrë periodike çfarë do të ndihmonte AKU-n në hartimin e planeve të inspektimit. Gjithashtu, të vlerësojë dhe gjejë zgjidhjet teknike për kërkesat që vijnë prej IQ dhe AKU të cilat i shërbejnë punës së tyre inspektuese.

*Nga auditimi rezulton se:* Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i hapave që ndjekin inspektorët në terren u konstatua se, rekordi i inspektimit mbyllet me gjenerimin e procesverbalit përfundimtar edhe në rastet kur në subjekt është marrë një mostër dhe përgjigja e saj kërkon një afat që është përcaktuar në aktet ligjore. Në rastet kur analiza mund të rezultojë me ngarkesë bakteriale apo mikrobiologjike, në sistem krijohet një autorizim i ri duke humbur kështu gjurmën me rekordin e inspektimit që ndodhet në sistem regjistruar nga inspektorët të cilët kanë kërkuar kryerjen e një analize laboratorike. Mbyllja e rekordeve kryhet në të gjitha rastet, nisur nga fakti se përgjigjet laboratorike nuk kthehen brenda afateve, dhe masat e marra në vazhdimësi të këtij inspektimi të kryer janë në kundërshtim me aktet ligjore, duke detyruar kështu krijimin e një tjetër inspektimi, por këtë herë bazuar në rezultatin e mostrës. Vonesa e përgjigjes së laboratorëve vë në rrezik konsumatorët, por njëkohësisht arritjen e objektivave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

**21.1 Rekomandimi:** AKU dhe IQ të marrin masa të menjëhershme në ndryshimin e hapave inspektues duke mos lejuar mbylljen e rekordeve inspektuese në sistem përpara afatit që përcakton ligji për marrjen e përgjigjes nga laboratorit për analizimin e mostrës. Në rastet kur afati ligjor i dërgimit të përgjigjes nga laboratorit është tejkaluar, rekordi mund të mbyllet automatikisht nga sistemi, meqënëse çdo masë ndaj subjektit do të përbënte një kundërvajtje ligjore nga ana e AKU-s.

*Nga auditimi rezulton se:* Meqënëse është pranuar nga IQ dhe janë marrë masat administrative për ndryshime në udhëzimet mbi procedurat e inspektimit në rastet e marrjes së mostrës, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

*Rekomandimi është zbatuar*

**22. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit, nëpërmjet testimeve të sistemit, u konstatua se:

- Në opsionin “About me” shfaqet error që tregon se nuk kemi asnjë mundësi të kryejmë veprime si ndryshimi i fjalëkalimit në kundërshtim me rregulloren që përcakton se ky veprim mund të kryhet nga përdoruesi sipas nenit 10, pika 3 ku citohet se “Portali ofron për çdo përdorues mundësinë e ndryshimit në çdo moment kohe të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij”;

- Opsioni “Dil”, nuk është komandë e zbatueshme nga ana e sistemit pasi përdoruesi mbetet i loguar në sistem edhe pas thirrjes së këtij opsioni duke lejuar nëpërmjet sistemit të ndodhin gabime njerëzore, por dhe gabime të qëllimshme pasi dikush tjetër mund të veprojë në emër të përdoruesit që mendon se ka dalë jashtë sistemit. Kjo problematikë rezulton e pa identifikuar, e pa raportuar dhe e pazgjidhur, megjithëse sistemi është ndërtuar që në vitin 2011.

**22.1 Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ si institucione administrues të sistemit e-inspektimi të kryejë testime në sistem për të verifikuar të gjitha problematikat që shfaqen në sistemit e-inspektimi ku në të bëjnë pjesë dhe opsionet e vetë administrimit të përdoruesit dhe ti adresojë problematikat të cilat vijnë si rezultat i mangësive në sistem tek AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes.

*Nga auditimi rezulton se:* Ky rekomandim është në proces zbatimi.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

*Nga AKU janë paraqitur komente/ observacione me shkresat nr. 177/3, datë 20.03.2023 dhe shkresën nr. 177/9, datë 11.04.2023, mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit duke reflektuar ndryshimet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

*Nga AKSHI janë paraqitur komente/ observacione me shkresën nr. 177/10, datë 26.04.2023, mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit. Grupi i auditimit i ka shqyrtuar sqarimet e dhëna nga ana juaj, për çdo rekomandim dhe vlerëson se për secilin rast nuk ka një ndryshim mbi statusin e zbatueshmërisë që është përcjellë në Projektraportin e auditimit. Për sa më sipër, nuk janë pasqyruar ndryshime në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.*

### 1.1.1 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 33 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 31 masa, nga të cilat janë zbatuar 15 masa, janë në proces zbatimi 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë pa zbatuar 5 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si më poshtë:

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1.1 Gjetje nga auditim:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë në AKU me shkresën nr.978/14 prot, datë 13.03.2022, në AKSHI me shkresën nr.978/12 prot, datë 30.03.2022 dhe në IQ me shkresën nr.978/13 prot, datë 30.03.2022, **nuk janë zbatuar rekomandimet (4.1, 15.1, 16.1, 17.2, 18.1), si vijon:**

**4.1 Rekomandimi:** AKSHI si ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes për sistemin e-inspektimi të marrë masat për vënien në dijeni të institucionit përfitues të shërbimeve të mirëmbajtjes që në këtë rast është IQ me qëllim informimin e institucionit mbi problematikat e raportuara nga IQ.

**15.1 Rekomandimi:** Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKSHI-n, si institucione administrues të sistemit e-inspektimi, ku AKSHI është njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrin masat për automatizimin e buletineve statistikore në sistemin informatik të inspektimit me qëllim minimizimin e raportimeve manuale që kryejnë gjithë përdoruesit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit përfshirë dhe inspektorët.

**16.1 Rekomandimi:** IQ dhe AKSHI si institucione administrues të sistemit e-inspektimi ku AKSHI njëkohësisht dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes të marrë masat për përmirësimin nga ana e OE detyrimit për importimin e të dhënave historike të AKU në sistemin e-inspektimi për të siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë historike dhe të gjurmueshme të të dhënave inspektuese që janë kryer ndër vite.

**17.2 Rekomandimi:** AKSHI të marrë masat në lidhje me sigurimin nga ana teknike të ruajtjes së gjurmës elektronike e cila do të ketë për qëllim sigurimin e investigimit të detajuar të veprimeve që ndodhin në sistemin e-inspektimi nga përdoruesit e tij.

**18.1 Rekomandimi:** AKSHI si institucion administrues i sistemit e-inspektimi dhe njëkohësisht ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes, të marrë masat për ndërtimin e raporteve në sistemin e-inspektimi, me qëllim ofrimin e kushteve të raportimit që i nevojiten aktivitetit të AKU-s.

**1.1 Rekomandim:** Strukturat përkatëse të institucioneve AKU, IQ dhe AKSHI, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet që nuk janë zbatuar rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e tyre.

***Brenda 6-mujorit të II të vitit 2023 dhe në vijimësi***

**2.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë në AKU me shkresën nr.978/14 prot, datë 13.03.2022, në AKSHI me shkresën nr.978/12 prot, datë 30.03.2022 dhe në IQ me shkresën nr.978/13 prot, datë 30.03.2022, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet (3.2, 20.2), si vijon:**

**3.2 Rekomandimi:** AKSHI dhe IQ, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI ku të përcaktohet qartë se cilat janë shërbimet, ofrimi si dhe zbatimi i tyre.

**20.2 Rekomandimi:** IQ në bashkëpunim me AKU-n të identifikojnë nevojat për përmirësim të sistemit e-inspektimi që kanë të bëjnë me procese të inspektimit, mbetur jashtë sistemit si procedura e asgjësimit prej fillimit deri në procesverbalin përkatës.

**2.1 Rekomandim:** Strukturat përkatëse të institucioneve AKU, IQ dhe AKSHI, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet e zbatuara pjesërisht rast pas rasti me qëllim përshpejtimin e procesit për zbatimin e plotë të tyre.

***Brenda 6-mujorit të II të vitit 2023 dhe në vijimësi***

**1.2 Agjencia e Prokurimit Publik – APP dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit -AKSHI**

***Mbi auditimin e ushtruar në APP dhe AKSHI, në bazë të Programit të Auditimit nr. 177/1 Prot, datë 20.02.2023.***

Në zbatim të pikave 1-4 të Programit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2022”.

**Objekti i auditimit:** Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e mëparshme me shkresën nr. 15/11 prot, datë 01.07.2022 drejtuar APP-s dhe me shkresën nr. 15/12 prot, datë 01.07.2022, drejtuar AKSHI-t.

Nga verifikimi i dokumentacionit, për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 18 masa organizative. Nga këto janë pranuar plotësisht 17, nga të cilat janë zbatuar 12, janë në proces zbatimi 3 dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative.

**Përmbledhëse e masave drejtuar institucioneve APP dhe AKSHI.**

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime Gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
<b>MASA ORGANIZATIVE</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>0</b>

## DREJTIMET E AUDITIMIT:

**1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

APP ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 4725/8 Prot., datë 22.07.2022 planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Agjencinë e Prokurimit Publik me objekt “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AKSHI, nuk ka kthyer përgjigje duke mos respektuar afatin 20 ditor.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

APP nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

AKSHI nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**3. Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.**

Trajtimi për ndjekjen e secilit rekomandim është përshkruar më poshtë:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Sektori i TI atashuar në APP është në mungesë të përgjegjësit dhe 1 (një) specialisti. AKSHI me shkresën nr.785 Prot., datë 04.02.2020 ka caktuar vetëm një specialist TI në APP, strukturë kjo e cila vazhdon ende të funksionojë si e tillë, duke sjell risk në mos përmbushje të objektivave institucionale.

-Sektorin e IT të AKSHI-t atashuar pranë APP përdor një bazë rregullatore të cilat nuk janë të miratuara nga organet drejtuese të AKSHI-t. Gjithashtu këto akte rregullore janë draft- akte të papërfunduara.

-Rregullorja e Brendshme e Agjencisë së Prokurimit Publik nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ri-organizimin e strukturës në Agjencinë e Prokurimit Publik. Konkretisht Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit në APP ka mbivendosje të detyrave funksionale me Rregulloren e Brendshme të AKSHI-it “Mbi detyrat dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, duke bërë që detyrat funksionale që duhet të kryheshin nga sektori i TI të AKSHI-t atashuar pranë APP realizohen nga Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit në APP. Përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit janë të pa përditësuara.

**1.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante të sektorit IT atashuar në APP.

*Nga auditimi rezulton se:* Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka marrë masa për plotësimin e vendeve vakante të sektorit IT atashuar në APP

*Rekomandimi është zbatuar*

**1.2.Rekomandimi:** Struktura drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa për miratimin e akteve rregullative në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore me qëllim reflektimin e ndryshimeve institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

*Nga auditimi rezulton se:* Propozimi i projektligjit “Për Qeverisjen Elektronike” për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është një hap drejt reflektimit të ndryshimeve institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

**1.3.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik me plotësimin e strukturës IT si organikë e AKSHI-t pranë saj të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operacionale në lidhje me ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar. Gjithashtu Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa dhe për përditësimin e përshkrimeve të punës në koherencë me rregulloren e brendshme.

*Nga auditimi rezulton se:* APP ka marrë masa për përditësimin e dokumenteve të cilat pasqyrojnë detyrat operacionale në lidhje me ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura me hyrjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

*Rekomandimi është zbatuar*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Agjencia e Prokurimit Publik, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore të drejtorisë së Administrimit të të Dhënave. Gjatë vitit 2021 kanë zhvilluar trajnime në lidhje me Menaxhimin Strategjik, Statistikë, mbi Prokurimin Publik etj, por në asnjë rast mbi administrimin e sistemit SPE. Gjithashtu, APP nuk disponon dokumentacione mbi propozimet përkatëse nga niveli menaxherial i APP (ku përfshihet dhe drejtorja e burimeve njerëzore) për zhvillimin e trajnimeve. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim, duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

- Stafi i Sektorit IT atashuar në Agjencinë e Prokurimit Publik nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit, në kundërshtim me rregulloren e brendshme të AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020 “Mbi detyrat dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

**2.1. Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit të drejtorisë së Administrimit të të Dhënave i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemin e SPE.

*Nga auditimi rezulton se:* APP ka marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit të drejtorisë së Administrimit të të Dhënave

## *Rekomandimi është zbatuar*

**2.2. Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për identifikimin e nevojave dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin aktual të sektorit IT atashuar në APP dhe në vijimësi me plotësimin e plotë të këtij sektori.

**Nga auditimi rezulton se:** Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka marrë masa për zhvillimin e trajnimeve për stafin aktual të sektorit IT atashuar në APP por nuk ka kryer identifikimin e nevojave për trajnime.

## *Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Oficeri i Sigurisë i përcaktuar me Urdhrin e titullarit të APP me nr. 9168/11 prot., datë 24.05.2019 “Për ushtrimin e detyrave”, nuk ka realizuar detyrat e përcaktuara në kundërshtim me Nenin 18 të Rregullores së Brendshme “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren e brendshme për organizimin e punës në Agjencinë e Prokurimit Publik” miratuar me Vendim nr. 03 datë 30.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP. Gjithashtu raportimi i tij sipas rregullores së brendshme të APP nuk kryhet në nivelin më të lartë drejtues të APP, në mospërputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia e tij dhe mund të shmangen konfliktet e interesit që lindin, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.

**3.1. Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa që të kryhen detyrat nga Oficeri i Sigurisë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të APP si dhe për rregullimin e linjës së varësisë në nivelet menaxheriale, ku raportimi i tij të jetë në nivelin më të lartë drejtues duke kryejë vetëm detyrat e Oficerit të Sigurisë dhe jo funksione të tjera, me qëllim garantimin e pavarësisë dhe shmangien e konfliktit të interesit, në ushtrimin e kompetencave të tij.

**Nga auditimi rezulton se:** APP ka marrë masa që të kryhen detyrat nga Oficeri i Sigurisë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të APP si dhe për rregullimin e linjës së varësisë në nivelet menaxheriale, ku raportimi i tij të jetë në nivelin më të lartë drejtues.

## *Rekomandimi është zbatuar*

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, regjistri i riskut i APP përgjatë viteve 2020 - 2021 nuk rezulton të ketë patur përditësime mbi risqet e reja të identifikuara, konkretisht:

-Nuk janë identifikuar risqet në burimet njerëzore, të cilat duhen adresuar për të siguruar mirëfunksionimin dhe administrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik;

-Nuk janë analizuar dhe identifikuar mbivendosjet e kompetencave dhe detyrave në lidhje me administrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik, si dhe hapat që do të ndërmerren për minimizimin e problemeve që mund të ndodhin në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSHI-t dhe APP-s.

-Ndarja ose transferimi i risqeve së bashku me asetet tek AKSHI duke qenë se transferimi i aktiveve është bërë gjatë vitit 2020, periudhë për të cilën APP nuk ka marrë masa për rishikimin dhe update-im e regjistrit të riskut për këtë periudhë;

-Nuk janë identifikuar risqe në lidhje me: sigurinë, disponibilitetin dhe integritetin e sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

**4.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa për përditësimin e regjistrit të riskut institucionale, si dhe në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Sistemin e Prokurimit Elektronik me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin /

parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave

***Nga auditimi rezulton se:*** APP ka marrë masa për përditësimin e regjistrit të riskut institucional, si dhe në bashkëpunim me AKSHI-n ka marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Sistemin e Prokurimit Elektronik me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve.

#### ***Rekomandimi është zbatuar***

**5.Gjetje nga auditimi:** APP nuk disponon një infrastrukturë BCC (Business Continuity, Center) për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, si dhe nuk është kryer azhurnimi i planit mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat.

**5.1.Rekomandimi:** AKSHI bazuar në VKM Nr.673 datë 22.11.2017 pika 6k për rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndërtimin e qendre *Business Continuity* si dhe të azhurnojnë dhe të testojnë planin e rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery plan) me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur..

***Nga auditimi rezulton se:*** AKSHI ka ndërmarrë hapa për ndërtimin e qendre Business Continuity.

#### ***Rekomandimi është në proces zbatimi***

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKSHI nuk kanë marrë masat e nevojshme për rritjen e sigurisë së informacionit në “*Sistemin e Prokurimit Publik*” dhe nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit si person përgjegjës në AKCESK në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 553, datë 15.07.2020 “*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*”.

**6.1.Rekomandimi:** AKSHI të marrin masat e nevojshme për përcaktimin e personit përgjegjës për infrastrukturën kritike “Sistemi i Prokurimit Publik” dhe vendimmarrjen t’ia komunikojë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

***Nga auditimi rezulton se:*** AKSHI ka marrë masa për përcaktimin e personit përgjegjës për infrastrukturën kritike “Sistemi i Prokurimit Publik” dhe vendimmarrjen t’ia komunikojë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

#### ***Rekomandimi është zbatuar***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se fjalëkalimi i administratorit të databazës është i ndarë në dy pjesë sipas përcaktimeve të Urdhrit nr. 4104 Prot., datë 21.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP-së. Gjithashtu sipas përcaktimeve të këtij urdhri bëhen ndryshimet dhe për ndryshimin e username dhe fjalëkalimit për: *Username dhe password i router; Username dhe password i switch; Akses i Server Management Storage; Akses i storage të DB (EVA, EVA2); Akses i storage EVA; Akses i C7000.*

Urdhri i sipërcituar i cili përcakton se një pjesë e fjalëkalimeve administrohet nga përfaqësuesi i APP dhe një pjesë e fjalëkalimeve administrohet nga specialisti i TI-s së AKSHI-t atashuar pranë APP, është hartuar dhe miratuar në mënyrë të njëanshme vetëm nga Titullari i APP dhe nuk ka marrë edhe miratimin e strukturave drejtuese të AKSHI-t, si palë administruese në proces.

**7.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një akti rregullativ të përbashkët për caktimin e administrimit të bazës së të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik, ku të përcaktohen qartë përgjegjësitë mbi administrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.



*Nga auditimi rezulton se:* Janë marrë masa për administrimin e fjalëkalimeve nga të dy insitucionet por nuk është hartuar një procesverbal i dakortësuar nga të dy palët.

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht***

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, APP nuk ka një akt rregullativ të brendshëm, me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10325, datë 23.09.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore”, neni 5, ku citohet se: “Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji”

**8.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik si institucion administrues i bazës së të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, të marrë masa për përmbushjen e përcaktimeve ligjore mbi rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore.

*Nga auditimi rezulton se: Me kalimin e fjalëkalimeve të SPE tek AKSHI, APP kërkon heqjen e përgjegjësive për zbatimin e rekomandimit.*

***Rekomandimi nuk është pranuar***

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nuk ka një akt rregullariv ku të përcaktohet lidhja ndërmjet pozicionit të punës të specialistit dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë në sistem.

Konkretisht për rolet:

- *Analist Prokurimesh*
- *Nëpunës i publikimit;*
- *Koordinator;*
- *Monitorues.*

**9.1.Rekomandimi:** APP të marrë masa për hartimin e një rregulloreje ku të përcaktohet qartë lidhja ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si përdorues i sistemit me qëllim uljen e riskut të dhënies së të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe mbivendosjes sëtributeve.

*Nga auditimi rezulton se:* APP ka marrë masa për hartimin e një rregulloreje ku përcaktohet lidhja ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si përdorues i sistemit.

***Rekomandimi është zbatuar***

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit të nënshkruar ndërmjet AKSHI-t dhe APP-s, nuk është përcaktuar se cili do të jetë administratori i sistemit në funksion të përcaktimit të procedurave organizative dhe teknike dhe masave për miratimin, krijimin, bllokimin apo ndryshimin e fjalëkalimeve të llogarive të përdoruesve nga Administratori i Sistemit të Prokurimit Elektronik në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar

**10.1. Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masat për përcaktimin e administratorit të sistemit në funksion të procedurave organizative, teknike dhe marrjen e masave për krijimin, bllokimin apo ndryshimin e fjalëkalimeve të llogarive të përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

*Nga auditimi rezulton se:* Janë marrë masa për përcaktimin e administratorit të sistemit në funksion të procedurave organizative, teknike dhe marrjen e masave për krijimin, bllokimin

apo ndryshimin e fjalëkalimeve të llogarive të përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

### ***Rekomandimi është zbatuar***

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nuk disponohet një akt rregullator për menaxhimin e logeve dixhitale në administratën publike, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike.

**11.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit t’i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Gjithashtu në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

**Nga auditimi rezulton se:** Institucionet përkatëse AKSHI-APP kanë marrë masa për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, veprimet ruhen në sistemet Core dhe eFiling.

### ***Rekomandimi është zbatuar***

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik u konstatua se:

- Administratori i sistemit i cili bën menaxhimin e llogarive të përdoruesve mbështetet në Manualin për Administratorin e Sistemit të Prokurimit Elektronik për Menaxhimin e Përdoruesve i cili është i pa update-uar, (Version 1, 2018).

- Nuk janë aplikuar në sistem kriteret e detyrueshme për rritjen e vështirësisë së fjalëkalimit për përdoruesit, si periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit etj, bazuar në pikën 4 “*Kërkesat e Sigurisë*” pika a. të rregullores për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar e implementuar politikat për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “*Kërkesat e Sigurisë*” pika b. të rregullores për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Administratori i sistemit i cili në sistem ka rolin System Admin është krijuar me “Data e Krijimit” 11/01/2018 si dhe nuk i ka të plotësuara të gjitha fushat në sistem. Kjo situatë sjell risk për humbjen e gjurmës audituese, risk për kryerjen apo moskryerjen e veprimeve të autorizuar në sistem;

-Ka përdorues për të cilët fushën “Hyr” që është username me të cilin përdoruesi logohet dhe fushën “Emri i Plote” janë si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren. Ky fakt mbart një risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë gjurmë mbi aktivitetin që kanë kryer;

- Për user-at në rolin e KVO fusha “Hyr” që është username me të cilin përdoruesi logohet nuk është sipas “*Manualit të përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik për Administratorin e Autoritetit kontraktor*”, formati i të cilit është “*emër.mbiemër*”. konstatohen raste që ky format është: emër\_mbiemër, emër\_mbiemërnumër, emër, emërnumër, emër.mbiemërnumër, etj.,

- Për user-at në rolin e Njesisë së Prokurimit fusha “Hyr” që është username me të cilin përdoruesi logohet nuk është sipas “Manualit të përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik për Administratorin e Autoritetit kontraktor”, formati i të cilit është “emër\_mbiemër”, konstatohen raste që ky format është: emër.mbiemër, emër\*mbiemër, emër\_numërmbiemër, emër\_mbiemërnumër, emër.mbiemërnumër, gërma e parë e emrit.mbiemër, emër, [emërmbiemër@gmail.com](mailto:emërmbiemër@gmail.com), etj..
- Administratori i Autoritetit Kontraktor në këtë rast Agjencia e Prokurimit Publik është me rolin “Amin. Ak”;
- Ekziston aktiv përdoruesi me fushën “Hyr” = xhensila që është username me të cilin përdoruesi logohet në rolin “Analist Prokurimesh” i hapur me Data e Krijimi 08/02/2016 dhe vazhdon të jetë ende aktiv. Kjo bie në kundërshtim me pozicionin e punës si përgjegjëse sektori duke mos e patur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat e analist prokurimesh, për të cilën mungon edhe përshkrimi i punës;
- Ekziston aktiv përdoruesi me fushën “Hyr” = gjergj që është username me të cilin përdoruesi logohet në rolin “Analist Prokurimesh” i hapur me “Data e Krijimi” 05/09/2007 dhe vazhdon të jetë ende aktiv. Kjo bie në kundërshtim me pozicionin e punës si Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit duke mos e patur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat e analist prokurimesh;
- Ekziston aktiv përdoruesi me fushën “Hyr” = lediokruja që është username me të cilin përdoruesi logohet në rolin “Analist Prokurimesh” i hapur me Data e Krijimi 03/20/2010 dhe vazhdon të jetë ende aktiv. Kjo bie në kundërshtim me pozicionin e punës si specialist në Sektorin e Koordinimit duke mos e patur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat e analist prokurimesh;
- Mbajnë statusin “aktiv” përdorues në rolin “auditor”, konkretisht auditues të KLSH-së, të cilët kanë përfunduar detyrat e tyre gjatë auditimit në terren dhe përdoruesit në sistem rezultojnë të jenë akoma aktiv;
- Rezulton se ka përdorues për të cilët fusha “Email” është NULL (i paplotësuar);
- Ekzistojnë përdorues për të cilët fusha “Email” është mm/dd/vv;
- Ekzistojnë përdorues për të cilët data e krijimit është ‘Po’ ose ‘Jo’.

*Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, hapja e këtyre përdoruesve mbetet pothuajse e pamonitoruar, pasi vetë APP nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre*

**12.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik të të njëjtës kategori sipas manualeve përkatëse, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara, të marrë masa për rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit si periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuara nga auditimi në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik.

**Nga auditimi rezulton se:** APP ka marrë masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik të të njëjtës kategori sipas manualeve përkatëse, dhe ka plotësuar të dhënat që mungojnë për çdo përdorues.

***Rekomandimi është zbatuar***

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nuk administrohet dokumentacion apo gjurmë dokumentare për monitorimin e treguesve të përcaktuar në Marrëveshje Nivel Shërbimi e nënshkruar ndërmjet APP dhe AKSHI-t. Shërbimet e përcaktuara në këtë

Marrëveshje Nivel Shërbimi, janë pak ose aspak të matshme, duke ndikuar në monitorimin e zbatimit të këtyre shërbimeve.

**13.1. Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijimësi të kryejë analizimin, prioritarizimin dhe ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në MNSH-në ndërmjet institucioneve (APP dhe AKSHI), hartimin e raporteve javore dhe mujore të shërbimeve të ofruara, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për kryerjen me rigorozitet të suportit të ofruar nga AKSHI.

*Nga auditimi rezulton se:* APP ka marrë masa për hartimin e raporteve javore dhe mujore të shërbimeve të ofruara, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për kryerjen e suportit të ofruar nga AKSHI.

*Rekomandimi është zbatuar*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi bazën ligjore dhe nënligjore të APP dhe AKSHI u konstatua se ka mbivendosje të kompetencave të detyrave dhe përgjegjësive mbi administrimin e sistemit të Prokurimit Elektronik, konkretisht: në nenin 4, pika 41 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, citohet se: “Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”, ndërkohë në pikën 9 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar, citohet: “AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave”. Në pikën 6 shkronja y) citohet se: “Administron nga ana teknike sistemin informatikë të institucioneve të përmendura në shkronjën “i”, të pikës 6, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive.”

Gjithashtu u konstatua se, APP dhe AKSHI në MNSH-në e nënshkruar nga të dyja palët nuk ka marrë në konsideratë rëndësinë e institucionit, ngarkesën apo sasinë e informacionit që APP përpunon dhe përfshirjen e plotë të elementeve të MNSH sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi në caktimin e kushteve të veçanta duke ndërmarrë masa për të përcaktuar kompetencat e detyrave dhe përgjegjësive mbi administrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (38-44) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1 Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si administratorë të sistemit SPE mbështetur në aktet ligjore respektive të marrin masa për ngritjen e një grupi të përbashkët me qëllim identifikimin e mbivendosjeve ligjore si dhe propozimin e hartimin e ndryshimeve të nevojshme në bazën rregullatore për të drejtat Administruese të Sistemit e Prokurimit Elektronik.

*Nga auditimi rezulton se:* APP ka marrë masa për nisjen e një komunikimi me AKSHI-n me qëllim identifikimin e mbivendosjeve ligjore si dhe propozimin dhe hartimin e ndryshimeve të nevojshme në bazën rregullatore për të drejtat Administruese të Sistemit e Prokurimit Elektronik.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të sistemit të Prokurimit Elektronik për vitin 2021 u konstatua se:

- Sistemi i prokurimit publik nuk ka kontrollet e nevojshëm të validimit për të mos lejuar lidhjen e kontratave pa pasur fondin limit të nevojshëm, ka raste në të cilat fondi i prokuruar është më i madh se vlera e fondit limit.
- Konstatohen fusha të pa plotësuar, çka tregon për mos vlerësimin e tyre si të detyrueshme për tu plotësuar. Rezultojnë raste procedurash të përfunduara dhe të arkivuara në të cilat nuk shfaqet vlera e kontratës dhe operatori ekonomik i shpallur fitues.

- Në prokurimet me vlerë të vogël në shumë raste është përdorur fondi limit me vlerë 0 (zero) ose 1 (një) duke shmangur gjurmët e procesit të prokurimit. Sipas udhëzimit Nr.3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të ndryshuar, me të cilën parashikohet që mos shfaqet fondi limit. SPE nuk ka filtrat e nevojshëm për të shmangur këto vlera.

- Në sistemin e Prokurimit Elektronik, fusha e cila përdoret për plotësimin e të dhënave të urdhrit të prokurimit (numrin dhe datën), është fakultative, jo e detyrueshme për tu plotësuar, veprimi i cili sjell risk në faktorin e “mos plotësisë” së të dhënave të sistemit.

**15.1 Rekomandim:** APP të marrë masat teknike të nevojshme për implementimin e mekanizmave të kontrollit të inputit në bazën e të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik për të garantuar integritetin dhe plotësinë e të dhënave që ruhen në të.

**Nga auditimi rezulton se:** APP ka marrë masa teknike të nevojshme për implementimin e mekanizmave të kontrollit të inputit në bazën e të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik

*Rekomandimi është zbatuar*

*Nga APP nuk janë paraqitur komente/ observacione mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, përcjellë në institucion me shkresën nr.177/6 , datë 20.03.2023.*

*Nga AKSHI janë paraqitur komente/ observacione me shkresën nr. 177/10, datë 26.04.2023, mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit. Grupi i auditimit i ka shqyrtuar sqarimet e dhëna nga ana juaj, për çdo rekomandim dhe vlerëson se për secilin rast nuk ka një ndryshim mbi statusin e zbatueshmërisë që është përcjellë në Projektraportin e auditimit. Për sa më sipër, nuk janë pasqyruar ndryshime në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.*

### 1.2.1 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 18 masa organizative. Nga të cilat janë pranuar plotësisht 17 masa organizative. Nga masat e pranuar, janë zbatuar 12 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan zbatuar pjesërisht si më poshtë:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.15/11 prot, datë 01.07.2022 drejtuar APP-s dhe me shkresën nr. 15/12 prot, datë 01.07.2022, drejtuar AKSHI-t, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet (2.2, 7.1), si vijon:**

**2.2. Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për identifikimin e nevojave dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin aktual të sektorit IT atashuar në APP dhe në vijimësi me plotësimin e plotë të këtij sektori.

**7.1.Rekomandimi:** Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një akti rregullativ të përbashkët për caktimin e administrimit të bazës së të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik, ku të përcaktohen qartë përgjegjësitë mbi administrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**1.1 Rekomandim:** Strukturat përkatëse të institucioneve APP dhe AKSHI, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet e zbatuara pjesërisht me qëllim përsheptimin e procesit për zbatimin e plotë të tyre.

*Brenda 6-mujorit të II të vitit 2023 dhe në vijimësi*

#### **IV. Të tjera**

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për rekomandimet të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht nga auditimi i ushtruar “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022*”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen në subjekt sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

---

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**